




ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

**REDUCE
REFUSE
RECYCLE**

**PËRGJEGJËSIA
SOCIALE**

2022

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguresit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.


FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Albsig Mundësoi Lindjen e Një Nëne të Re Ukrainase, Pranë Spitalit Hygeia në Tiranë.



Asaj i duket tashmë si një ëndërr, i duket gjithçka që ka kaluar si frekuencat e një filmi, por që i ka rilindur shpresat e së ardhmes pasi kaloi kufijtë e atdheut të saj të lënë mes gërmadhve të luftës. E reja ukrainase shtatëzëne i shpëtoi luftës e vetme pa bashkëshortin e saj. Bëhet fjalë për një 28-vjeçare ukrainase, e cila ka pak ditë që ka ardhur në Shqipëri. Ajo ka ardhur pa bashkëshortin e saj, por nuk ndihet vetëm dhe e pa mbrojtur. Tashmë zoti e ka bekuar me një ëngjëll të vogël që i ka ndryshuar jetën. Miroslav është ukrainasi i sapolindur në Tiranë. Procesi i lindjes së Miroslav-it është sponsorizuar nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig pranë Spitalit Hygeia. Vetëm falë Albsig, ukrainases së re i janë plotësuar të gjitha kushtet për të patur një lindje të mbarë dhe pa probleme shëndetësore si për të dhe për të voglin e saj të porsalindur. Ajo është mirënjohëse ndaj gjithësecilit që e ka ndihmuar për ta transportuar nga Ukraina në Shqipëri dhe gjithashtu nuk le pa falenderuar dhe Shoqërinë Albsig, e cila ishte mbështetëse e saj në momentin më të rëndësishëm të jetës së saj siç ishte ardhja në jetë e Miroslav. E reja fjalëpakë e me shumë mirënjohje tregon se bashkëshorti i saj është pjesë e ushtrisë së Ukrainës. Mes lotësh ajo tregon se bashkëshorti i saj është vënë në dijeni për ardhjen në jetë të djalit të sapolindur.

“Falenderoj Shoqërinë Albsig, e cila ishte mbështetëse në momentin më të rëndësishëm të jetës sime.”

— nëna e Miroslav

Dhe jo vetëm kaq, por mes lotësh ajo thotë se përmes kamerave të telefonit i ati i Miroslav e ka parë të voglin për herë të parë. Ajo shpreson shumë që shumë shpejt do mund të ketë mundësi të mbarojë lufta dhe të bashkohet me bashkëshortin e saj dhe së bashku me Miroslav të kenë një jetë të qetë. Miroslav është fëmija i pestë i lindur në Shqipëri nga nënat ukrainase të deklaruara deri tani në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri nga mesi i muajit Mars deri tani kanë mbërritur më shumë se 300 ukrainas, të cilët kanë filluar të përshtaten me jetesën këtu. Bledi Bajraktari -Konsulli i Nderit të Ukrainës, gjatë një emisioni televiziv tha se në Shqipëri kanë lindur fëmijët e parë të grave ukrainase, të cilat i kanë shpëtuar luftës në Ukrainë. “Kushdo që ka ardhur në mënyrë individuale dhe ne nuk e dimë do u thoja të lenë kontaktet në Ambasadën e Ukrainës dhe t’u vijmë në ndihmë. Një pjesë e kanë përdorur mbërritjen për të ikur në Shqipëri. Është rritur numri me dhjetëra. Kemi dhe të lindurit e parë. Një vajzë refugjate para dy ditësh solli në jetë djalë e saj,” u shpreh Bajraktari. Më tej Konsulli tregoi se ukrainasit kanë filluar edhe kërkesat e para për të marrë statusin e azilantit në vendin tonë. “Kemi edhe kërkesa për azil në vendin tonë. Janë disa procedura ligjore që do të ndiqen dhe janë procedura burokratike dhe nuk kemi hasur probleme. Disa janë përshtetur,” tregoi Konsulli. Ai falenderon çdo biznes e sipërmarrje që bën të mundur ndihmesën e shtetasve ukrainas në Tiranë. Gjithashtu bën thirrje gjithkujt që sipas mundësive që ata kanë të kontribuojnë me ndihma për shtetasit ukrainas që janë në luftë. Deri tani janë mirënjohes për gjithësecilin qytetar e biznes që ka kontribuar pranë tendave të ngritura pranë Bashkisë së Tiranës për mbledhjen e ndihmave për Ukrainën.

Albsig, Pjesë e Panairit të Punës ku Morën Pjesë 30 Kompani Biznesi për 800 Vende Pune

Panairi i Punës, i zhvilluar para pak ditësh në Tiranë, tërhoqi interes jo vetëm nga punëkërkuar, por edhe të rinj të interesuar për trajnime profesionale. I konsideruar si një nga aktivitetet më të rëndësishme në fushën e tregut të punës, panairi bëri bashkë biznesin, punëkërkuar, institucionet publike dhe private që ofrojnë shërbime punësimi dhe institucionet e Arsimit dhe Formimit Profesional që përgatisin profesionistë të kërkuar në tregun e sotëm të punës. Në panair morën pjesë 30 kompani biznesi më në zë ku pjesë e tyre është dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrioti Group, e cila hapi siparin e saj për rekrutimin e punëkërkuar dhe të rinjve të interesuar në këtë event. Panairi i këtij viti duket se ka në fokus krijimin e një sinergjie në tregun shqiptar të punës, sidomos në komunikimin midis punëkërkuar dhe punëdhënësit. "Shoqëria Albsig prej dy ditësh ka hapur dyert për të mirëpritur

kandidaturat e ndryshme të të rinjve dhe punëkërkuarve për t'u bërë pjesë e kësaj shoqërie të madhe", kështu është shprehur në panair Drejtoreja e Marketingut të Albsig, Valbona Dako. Sipas saj numri i personave që e kanë vizituar stendën e Albsig dhe që kanë aplikuar për punë në këtë panair është i madh, duke i kaluar edhe pritshmëritë. Dy ditë janë dedikuar punësimit dhe aftësimi profesional të të rinjve dhe punëkërkuarve nga stafi i Albsig. Ky panair vjen si një nismë ku bëhen bashkë Bashkia e Tiranës me Ambasadën Greke në Tiranë dhe Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri. Albsig ka suportuar gjithmonë, jo vetëm punëkërkuar, por dhe të rinjtë sidomos studentët e universiteteve private dhe shtetërore duke u bërë pjesë e një sërë panairësh dhe work-shop-esh. Albsig është dhe do të jetë gjithmonë përkrahëse e të rinjve për t'ju dhënë atyre mundësinë e punësimit.

Panairi Punës 2022







Albsig Merr Pjesë në Panairin e Punës në Fakultetin Ekonomik.



Më 28.04.2022 Fakulteti Ekonomik, pjesë e Universitetit të Tiranës, organizoi "Panairin e Punës". Stafi i fakultetit së bashku me studentët mirëpritën shumë prej kompanive më prestigjioze në Tiranë, të cilat përmes prezantimeve, fletushkave e materialeve të tjera promovuese, njoftuan studentët për mundësitë e punës dhe pranuan CV-të e tyre për t'i shqyrtuar për punësim. Pjesë e këtij eventit-trajnimi ishte dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup.

Studentët patën mundësi të informoheshin për shumë mundësi praktike dhe punësimi të ofruara nga Shoqëria Albsig. Albsig ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetës i përhershëm i avancimit dhe ndërtimit të karrierës së studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre. Pjesëmarrja në këtë panair synon përfshirjen dhe edukimin e brezave të rinj në sektorin e sigurimeve dhe investimeve.

Falë këtij aktiviteti, studentët u njohën më nga afër me mundësitë e praktikave profesionale dhe të punësimit që Albsig ofron në departamente të ndryshme.



Për punën e sotme, mos apliko nesër!





Mendo, Ndrysho, Fito

Është ky trajnimi i dedikuar rritjes dhe zhvillimit profesional realizuar nga Ermal Mamaqi.

Mendoje veten tënde në momentet e tua të fundit të jetës: Çfarë do të të thoshte vetja? Si do të ndiheshe për jetën që ke jetuar? PSE NUK I BËRE REALITET TË GJITHË ËNDRRAT QË PATE?

Ti meriton të jetosh jetën në kuptimin e plotë të saj, dhe kjo nuk do të ndodhë nëse ti nuk punon çdo ditë me veten. Cilat janë gjërat në të cilat duhet të fokusohesh vërtet? Cilat janë besimet kufizuese që po të mbajnë pas? Si mund ta çlirosh potencialin tënd të plotë?

Merr përgjegjet e këtyre pyetjeve dhe të tjera, në trajnimin që do të ndryshojë jetën tënde: "MENDO, NDRYSHO, FITO". Pyetjeve të mësipërme i kanë dhënë përgjigje një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish në trajnim. Në trajnimin e datës 5 dhe 6 Mars zhvilluar në Tiranë kanë marrë pjesë dhe stafi i Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Stafi i Albsig është njohur me teknika dhe informacione që mund të ndihmojnë ata të kenë shëndet më të mirë, financa, marrëdhënie më të mira me veten dhe njerëzit.

Ermal Mamaqi ju bëri thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trajnim, sipas tij TANI është koha që ti të arrish qëllimet dhe të marrësh kontrollin e jetës tënde - MENDO, NDRYSHO, FITO është trajnimi që do ta çojë jetën tënde në një tjetër nivel!



“Mjeshtëro Biznesin”

**Albsig Pjesëmarrës në
Event-trajnimin më të
Madh në Shqipëri e
Rajon.**

“Mjeshtëro Biznesin”, është event-trajnimi i parë më i madh në Shqipëri dhe në rajon kushtuar biznesit, event në të cilin mori pjesë dhe Albsig. Stafi i Albsig ka qenë në një rrugëtim 3-ditor në të cilin morën pjesë 800 pjesëmarrës nga bizneset më të njohura mbarë shqiptare dhe mbi 30 orë trajnim intensiv me skuadrat më të mira në fushat e ndryshme të biznesit.

Albsig ka marrë pjesë në trajnimin e përvitshëm të realizuar nga Vasil Naçi dhe skuadrën e tij. “Mjeshtëro Biznesin” është një program i ideuar për sipërmarrësit, drejtuesit dhe këdo që dashuron biznesin dhe ka pritshmëri dhe standarde individuale shumë të larta. Gjatë tre ditëve të “Mjeshtëro Biznesin”, Vasil Naçi dhe skuadra e tij e ekspertëve, janë fokusuar në mënyrën e ndërtimit të kulturës, strategjive, sistemeve dhe burimeve e praktikave më të mira për sukses afatgjatë. Albsig ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë promotore e risive dhe trendeve të momentit.

Zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve është procesi i investimit strategjik të kohës, energjisë dhe burimeve në përmirësimin e personelit të kompanisë. Trajnimi paraqet një mundësi reale për të zgjeruar bazën e njohurive të të gjithë punonjësve. Trajnime të tilla do t'i japin punonjësve aftësi të reja, një kuptim më të madh të përgjegjësisë brenda rolit të tyre dhe nga ana tjetër të ndërtojnë vetëbesimin e tyre. Vetëbesimi dhe njohuritë që marrin punonjësit do të përmirësojë performancën e tyre të përgjithshme dhe kjo shkon në të mirë të kompanisë. Punonjësit që janë kompetent dhe në krye të ndryshimit të standardeve të industrisë ndihmojnë kompaninë të mbajë një pozicion udhëheqës dhe të jenë konkurrentë të fortë brenda industrisë.



“Toka Është Shtëpia Jonë”



Toka është shtëpia jonë, është vendi i vetëm ku njerëzit marrin ajrin, ushqimin dhe nevojat e tjera për një jetesë të shëndetshme. Të kujdesemi për të! Është kjo thirrja e brendëshme që e ka secili prej nesh. Mjediisi rreth nesh është një pjesë thelbësore e mbijetesës njerëzore dhe luan një rol thelbësor për një jetesë të shëndetshme, prandaj duhet sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për njerëzit e sidomos gjeneratat e reja, që ta ruajnë dhe të kujdesen për ambientin.

Kësaj thirrjeje i është përgjigjur pikërisht në Ditën e Tokës dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig duke dalë në terren për të pastruar parqet dhe lulishtet e kryeqytetit. “Sot është një ditë shumë kuptimplotë e cila na kujton se sa i rëndësishëm është mjediisi ku

jetojmë. Së bashku me një grup të punonjësve të Albsig vendosëm të japim kontributin dhe një mesazh për të mbajtur pastër një ndër zonat, e cila luan rolin e mushkërisë për kryeqytetin tonë.

“Përgjegjësia sociale në kompaninë tonë do të ketë vëmendje të shtuar edhe me projekte të tjera ku sigurisht pas mbjelljes së pemëve dhe pastrimit të sotëm, aktivitete të tjera do të pasojnë në muajt në vijim po në këtë kuadër”, kështu është shprehur Valbona Dako, Drejtoreshë Marketingu në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig.

Plot 40 punonjës të Albsig të ndarë në dy grupe kanë mundur të pastrojnë parkun pranë Kopshtit Zoologjik në Tiranë. Punonjësit e Albsig të veshur

me uniformat përkatëse, të udhëhequr nga punonjësit e Bashkisë kanë mundur të pastrojnë një zonë prej afro 10 hektarësh duke mbledhur më shumë se 15 ton mbeturina urbane.

Sipas Drejtoreshës së Marketingut, nuk ka mënyrë më të mirë për t'u kthyer në kontakt me natyrën se sa për të dalë në natyrë dhe për të provuar mrekullitë e shumta të saj. "Arsyeja e aktivitetit është rritja e ndërgjegjësimit dhe t'i ftojme qytetarët të eksplorojnë bukuritë e natyrës dhe të mbrojnë mjedisin sa më shumë që të jetë e mundur, e jo vetëm në Ditën e Tokës", theksoi Dako.

Ajo i bën thirrje çdo institucioni që të nisin të parët pastrimin dhe kujdesin për mjedisin, "Bëhuni vullnetarët e parë të cilët pastrojnë mjedisin përreth jo vetëm në Ditën Ndërkombëtare të Tokës. Krijoni grupe vullnetare të ndryshme ose bëhuni pjesë e tyre".

Një mjedis më i pastër sot, do të thotë një mjedis më i shëndetshëm nesër. E ardhmja duhet të jetë e fokusuar në gjelbrim dhe rekreacion në këtë ambient, duke qenë të gjithë të përkushtuar për mbrojtjen e ambientit dhe gjelbrimin e tij.



Albsig tek Fëmijët e Jetimores Shkodër për Festën e 1 Qershorit



1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Kjo ditë është një festë e madhe e dedikuar tërësisht buzëqeshjeve dhe lumturisë së vogëlushëve kudo në botë. Por nuk është vetëm një ditë festive, kjo është një ditë sensibilizimi për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është një ditë ndërgjegjësimi ku gjithësecili duhet të hedhë sytë rreth fëmijëve. Prandaj në këtë ditë të shënuar, Shoqëria e Sigurimeve Albsig, përzgjedhi të ishte pranë fëmijëve në Insitucionin "Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç, Shkodër", për të plotësuar dëshirat e tyre, në Ditën e 1 Qershorit, e cila iu dedikohet fëmijëve dhe të drejtave të tyre, në të gjithë botën.

Në kuadër të përgjegjesisë sociale, Shoqëria Albsig ka përzgjedhur, këtë institucion rezidencial të Përkujdesit Social për fëmijët e moshës shkollore, në qytetin e Shkodrës për të përmbushur dëshirat e tyre me disa dhurata simbolike. Dhurata të personalizuar për secilin fëmijë, të blera siç ata kanë kërkuar t'i kishin atë ditë. Njëkohësisht ëmbëlsirat dhe çokollatat nuk munguan për ta në këtë ditë të shënuar. Atmosfera e zbuluar për festë në Institucionin e Përkujdesjes Sociale priti grupin e punës së Albsig të përfaqësuar nga punonjësit e Shkodrës me drejtuese Rozana Marleci, Drejtoreshë, Dega Shkodër 1, ALBSIG.

"Fëmijët janë e ardhmja, e nëse duam të kemi një të ardhme më të mirë duhet të kujdesemi për ata sot, në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me formimin e tyre dhe dhurimin e një fëmijërie sa më të bukur, plot dashuri, si një siguri për një shoqëri të emancipuar nesër". -ishin fjalët dhe motoja e përfaqësueseve të Albsig Shkodër.

Albsig është dhe do të jetë gjithmonë në mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre në të gjithë vendin. Albsig në kuadër të përgjegjesisë sociale ka mbrojtur gjithmonë të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre në vend. Numërohen një sërë aktivitete në kuadër të të drejtave të fëmijëve të mbështetura nga Albsig, jo vetëm në ditën e shënuar të tyre, por edhe ato kur kanë pasur nevoja emergjente.

Kastrati Grup i Dhuron Komunitetit Mysliman Xhaminë e Re në Mullet.

Jo larg qendrës së Tiranës në zonën e Mulletit, kryeqytetit tashmë i është shtuar dhe xhamia më e re. Xhami e cila është dhuratë e sipërmarrësit shqiptar Shefqet Kastrati. Ajo tashmë është cilësuar si kulti fetar i kryeqytetit, më i veçanti në vend dhe jo vetëm. Arkitektuara mahnitëse, projekti i veçantë, punimet e brendshme dhe dizenjimet moderne ndërthurur me ato tradicionale i kanë shtuar jo vetëm zonës, por gjithë vendit një gur në gjerdanin e veprave mahnitëse arkitekturore fetare. Edhe pse është ndër xhamitë më të reja të sapo përruara, ajo duhet konsideruar si vepër arti e cilësive Evropiane. Arkitektura e jashtme dhe e brendshme e ndërthurur dhe me pozicionin gjeografik që foltorja ka, ka bërë që të dalin në pah dhe më shumë veçantitë e saj. Xhamia në Mullet mori emrin e një ndër besimtarëve më të devotshëm dhe më të respektuar që nga koha e komunizmit e deri në ditët e sotme, Z. Jonuz Hajredin Kastratit, babait të presidentit të Grupit

Kastrati, Z. Shefqet Kastrati. Edhe pse në moshë të thyer, Jonuz Kastrati udhëton disa herë drejt Mekës për të qenë gjithnjë e më afër me fenë Islame. Ai ka qenë dhe është gjithmonë pranë njerëzve të komunitetit duke u kujdesur dhe duke krijuar besim tek ata. Trashëguar dhe nga të parët e tij, për Shefqet Kastratin besimi në Zot është një nga pikat e tij më të forta, ndaj dhe zhvillimin e bizneseve të tij, ai gjithmonë e shikon si një mundësi për t'u shërbyer njerëzve, për t'i ndihmuar ata dhe për të krijuar dhe rritur mirëqenie. Ai kurrë nuk ka hequr dorë dhe nga bamirësia, duke iu gjendur pranë kujtdo në ditë të vështira. Kastrati Group është familja e tij e madhe, e cila mban të lidhur rreth vetes mbi 5.000 familje shqiptare. Pikërisht këto virtyte janë zemra e kësaj sipërmarrjeje të suksesshme, e cila në 30 vite është zgjeruar në mënyrë konstante dhe ka krijuar një reputacion të konsoliduar për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.





Albsig, Dhuratë Sete Kompjuterash për Shkollën “Gjon Buzuku”

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group” dhuroi kompjutera për shkollën 9-vjeçare “Gjon Buzuku”, në Tiranë. Fëmijët janë e ardhmja e vendit! Janë gjenerata më e re që do ta bëjnë botën më të mirë. Prandaj, kjo ndihmë vjen nga Albsig në kuadër të projektit SMIP, nisur nga Qeveria Shqiptare. Ky projekt lidhet drejtpërdrejtë me përmirësimin e sistemit arsimor digjital.

“Kjo ndihmë na vjen pikërisht në momentin kur kishim më shumë nevojë, sepse nga viti i kaluar ka filluar programi SMIP, Sistemi i Menaxhimit të Arsimit Parauniversitar, i cili ka të bëjë me regjistrimin e të dhënave në mënyrë digjitale për të gjitha shkollat. Kjo ndihmë na shërben për mësuesit, nxënësit, laboratorin e informatikës dhe për shkollën në tërësi”, u shpreh Zeqir Hasa, nëndrejtori i shkollës 9-vjeçare “Gjon Buzuku”, në Tiranë.



Nuk ka dëshirë më të madhe natyrore se sa dëshira për dituri.



Sipas tij thirrjes së menjëhershme për ndihmë të komunitetit të nxënësve të kësaj shkolle i erdhi në mënyrë të menjëhershme Albsig, sepse brezi i ri është e ardhmja e një bote më të mirë.

Shkolla "Gjon Buzuku" është një ndër shkollat më të mira në kryeqytet me një kapacitet të konsiderueshëm nxënësish. Janë rreth 1200 nxënës që mësojnë pranë kësaj shkolle. "Është kënaqësi për Albsigun që bëri këtë donacion modest për të ardhmen e nxënësve të shkollës "Gjon Buzuku" në laboratorin e informatikës", u shpreh Valbona Dako Drejtoreshë e Marketingut në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, pjesë e "Kastrati Group".

Sipas drejtoreshës thirrjeve të tilla do t'i përgjigjet gjithmonë Albsig sepse vlerëson dhe ndihmon gjithmonë gjeneratën e re.





Albsig - Pjesë e Çeljes së Sezoni Turistik në Lezhë

Lezha, një qytet historik e mikpritës ka çelur sezonin turistik edhe këtë vit. Falë punës së Bashkisë Lezhë, tashmë ajo është kthyer në atraksion model të turizmit, gastronomisë e pastërtisë urbane. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e "Kastrati Group" kishte kënaqësinë të ishte pjesëmarrëse në hapjen e sezonit të ri turistik në Shëngjin. Sigurimet e hoteleve dhe rëndësia e tyre ka qenë dhe qëllimi i pjesëmarrjes së Albsig në këtë eveniment.

Albsig është një ndër shoqëritë e sigurimeve që ka bërë të mundur edukimin e biznesit mbi rëndësinë e sigurimeve vullnetare dhe jo vetëm. Gjatë kësaj dite të veçantë u bë e mundur shpërndarja e broshurave informuese rreth sigurimeve për bizneset e zonës. Jo vetëm kaq, por një grup ekspertësh të kësaj fushe informuan drejtuesit dhe pronarët për rëndësinë e sigurimeve të hoteleve dhe bizneseve të tyre në këtë zonë. Ky informacion kishte për qëllim bashkëpunimin në funksion të përvojave me interes të përbashkët dhe mundësimin e ofertave të ndryshme me synim përgatitjen sa më cilësore dhe profesionale të sigurisë së hoteleve dhe jo vetëm.

Manifestim i shkëlqyer në bregdetin e plazhit të Shëngjinit, ku Bashkia Lezhë çeli sezonin e ri turistik të këtij viti, mbledhi bashkë biznese të ndryshme jo vetëm të zonës por dhe më tej. Tashmë, gjithçka është bërë gati dhe operatorët turistikë kanë hapur portat e mikpritjes për pushuesit vendas e të huaj. Shëtitorja e qytetit bregdetar të Shëngjinit u mbush me qytetarë, pushues dhe personalitete të jetës kulturore e politike dhe të ftuar nga Kosova e trojet e tjera shqiptare. Përveç koncertit, nuk munguan dhe takimet me bizneset e zonës për rëndësinë e cilësisë së turizmit duke mos harruar dhe rëndësinë e sigurimeve për ta.



Bregdet, Albsig Fushatë Sensibilizuese për Një të Ardhme më të Sigurt



Jemi gjithmonë pranë jush për ta bërë verën më të bukur dhe më të sigurt me Albsig.

Albsig këtë vërë ka zhvilluar një fushatë sensibilizuese për një të ardhme më të sigurt. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group ka ofruar për pushuesit, jo vetëm informacione të nevojshme, por ka dhuruar edhe materiale promociionale argëtuese. Ka qenë bregdeti i jugut të Shqipërisë që një fundjavë është "veshur" me të kuqen e Albsig.

Një pjesë e mirë e pushuesve janë pajisur me materiale promociionale verore për fëmijë. Një sasi e konsiderueshme artikujsh promociionale dhe lodra për fëmijë siç janë: loja pingpong, çanta termike, peshqirë plazhi, frizbi, etj janë shpërndarë për pushuesit e bregdetit të jugut. Fushata sensibilizuese për një të ardhme të sigurt në Albsig ka nisur në Durrës dhe ka përfunduar në Sarandë.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Albsig në bashkëpunim me drejtorët e Degëve të Albsig nëpër rrethe morën nismën për sensibilizimin e pushuesve që të bëjnë sigurimet e duhura në Albsig.

Fushata kishte për qëllim aktivizimin e qytetarëve në nivel lokal që të ndikojnë në sensibilizimin e komunitetit vendas për rëndësinë e sigurimeve në vend. Ndryshe nga herët e tjera, grupi i Marketingut të Albsig ka qenë prezent në çdo çadër të pushuesve përveçse për t'ju dhuruar artikujt promocionalë për t'ju shpjeguar atyre rëndësinë e sigurimeve.

Njëkohësisht grupi i Marketingut beri të mundur sensibilizimin e konsumatorëve për sigurimet ku, sipas tyre sigurimet, jo vetëm që mbrojnë financat personale të gjithësecilit prej nesh, por dhe të çdo familjeje shqiptare.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Albsig theksuan se fushata të tilla bëhen për të sensibilizuar, jo vetëm pushuesit nëpër bregdet, por edhe emigrantët e ardhur në atdhe, pasi një pjesë e mirë e tyre ndikojnë shumë në mentalitetin e zonës ku ata banojnë.



Albsig i Bashkohet Nismës së Bashkisë së Tiranës për Ndhimë të Studentëve



Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup, i është përgjigjur pozitivisht thirrjes së Bashkisë së Tiranës drejtuar bizneseve dhe kompanive të ndryshme private për të kontribuar me shërbime që do të ofrohen falas apo me pagesë të reduktuar studentëve të universiteteve të Tiranës nëpërmjet Kartës së Studentit. "Albsig.sh.a", një nga Shoqëritë e Sigurimeve që ofron sigurime, jo vetëm për studentët, por dhe familjarët e tyre, iu bashkua kësaj nisme dhe të gjithë studentët që janë pajisur me kartë studenti do mund t'i përfitojnë produktet e Albsig me një ulje të konsiderueshme në çmim. Nëse keni Kartën e Studentit, ejani në Albsig dhe zbuloni uljet mbi ulje të dedikuara vetëm për ju studentë të dashur.

Në këtë periudhë të jesh student në Shqipëri është një sfidë, këtë të gjithë e pranojmë. Është mirë që çdo student të ketë partnerin e tij të sigurisë që ta ndihmojë duke i ofruar lehtësira që në hapat e para të jetës studentore jashtë familjes. Albsig, lider në tregun e sigurimeve, ka përqaftuar projektin e iniciuar nga Bashkia e Tiranës në Janar 2021 për të mbështetur studentët duke u ofruar çmime preferenciale vetëm për ata që janë mbajtës të Kartës së Studentit.



Janë mbi 36,000 të rinj dhe të reja që kanë përfituar nga kjo paketë me çmime preferenciale.

Për ju që nuk na keni vizituar ende, ne themi hajde në Albsig dhe merr ULJE EKSTRA. Sigurimet e nxënësve, studentëve brenda dhe jashtë vendit, sigurimet e makinave, sigurimet e shëndetit dhe të pronës për ju dhe familjarët tuaj, Albsig ka menduar një sërë uljesh si më poshtë.

Lista e Shërbimeve

Sigurim i Aksidenteve dhe Sëmundjeve

Sigurim i Nxënësve dhe Studentëve
Sigurim Shëndeti
Sigurim Shëndeti në Udhëtim

Sigurim i Mjeteve Motorike i Detyruar

Sigurim i Mjetit Motorik për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (TPL)
Kartoni Jeshil
Sigurimi Kufitar i Mjetit Motorik

Vullnetar

Sigurim Mjeti Kasko
Sigurim Mjeti Mini-Kasko

Sigurim i Pasurisë për Studentët dhe Familjarët e Tyre

Sigurim nga Zjarri, Tërmetet dhe Rreziqet Shtesë
Sigurim nga Vjedhja

Oferta e Reduktuar (oferta për studentët)

30% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

15% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

20% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

40% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

Albsig ka qenë dhe është përfshirë gjithmonë në nisma të tilla të përgjegjësive sociale. Studentët e siguruar të sotëm janë profesionistët e së ardhmes dhe ne jemi të bindur që çdo ndihmë sado e vogël për ta sot, do të na kthehet shumëfish nesër. Karta e Studentit është mjeti nëpërmjet të cilit studentët përfitojnë mjaft avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, si nga institucionet publike, ashtu edhe nga subjektet private.

Pajjsja dhe paraqitja e kartës është e detyrueshme nga ana e çdo studenti për përfitimin e këtyre avantazheve. Në rrjetin e shërbimeve publike, me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Publike", paraqitja e kartës është e mjaftueshme. Në rrjetin e shërbimeve private partnere të grupuara në platformën "Karta Extra", me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Private", studentët përfitojnë uljet dhe ofertat e dedikuara për ta, në formë pikësh të ngarkuara në kartë nëpërmjet leximit të saj nga sistemi (jo thjesht paraqitjes së kartës) që përdor secili prej aktiviteteve private.

Këto pikë të grumbulluara, studenti kartëmbajtës mund t'i përdorë si vlerë monetare për të realizuar çdo lloj blerje në të gjithë rrjetin e këtyre subjekteve private, të cilët i janë bashkuar nismës së Bashkisë Tiranë.





Tetori Rozë, Albsig, Kontroll Falas për Stafin.

Mos prit muajin Tetor, drejtoje fokusin te siguria e shëndetit tënd!

Vetëkontrolli mujor dhe ekzaminimi nga personeli shëndetësor janë mënyrat e kontrollit më efektive që ndihmojnë në diagnostikimin në kohë të kancerit të gjirit! Edukimi dhe informimi për shenjat dhe simptomat që lidhen me kancerin e gjirit janë kryesore gjatë këtij muaji.

MOS NEGLIZHO!!

Drejtesit e Albsig për t'i shprehur mirënjohjen dhe përkushtimin stafit të shoqërisë në kuadër të ndërgjegjësimit të Tetorit Rozë kanë hartuar një "nismë" të brendshme për kontroll shëndetësor falas të dedikuar vetëm për stafin e shoqërisë. Mënyra që ata kanë gjetur për të ndihmuar stafin është një kontroll i specifikuar falas për të gjitha gratë dhe vajzat e Albsig.

"Mbështet shpresën, lufto për jetën", kështu është titulluar nisma që ka ndërmarrë Albsig këtë vit të dedikuar vetëm për stafin e saj. Përmes kësaj nisme synohet rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për sfidat shumë të vështira, me të cilat ndeshen çdo ditë gratë që luftojnë me kancerin e gjirit; si dhe të kërkohen rrugët e mjetet efikase për të ndikuar pozitivisht në luftën kundër kancerit të gjirit në përgjithësi e në mënyrë të veçantë për trajtimin e pacienteve me këtë sëmundje.



“Mbështet shpresën, lufto për jetën”

Nisma e ndërmarrë filloi me njoftimin e stafit të Albsig përmes një e-mail, në të cilin u sqarua secila punonjëse se si do të veprojë përgjatë muajit Tetor për mundësinë e përfitimit të kontrollit falas nga Albsig.

Janë njoftuar të gjitha gratë dhe vajzat për të gjithë intenerarin që do të ndjekin secila prej tyre dhe për mundësinë që ato do të përfitojnë për identifikimin e çdo problematike që mund të hasin në shëndet. Stafit të grave dhe vajzave të Shoqërisë Albsig, iu premtua se do të kenë mbështetjen e drejtuesve gjithmonë, jo vetëm me rastin e muajit të ndërgjegjësimit siç është Tetori Rozë.

Sot është e mundur që diagnostikimi i hershëm të shpëtojë jetën. Tani që startoi Tetori Rozë, ky startim fillon me muajin e ndërgjegjësimit në përpjekje për parandalimin e kancerit të gjirit. Kjo fushatë ndërkombëtare vjetore synon të edukojë rëndësinë e kontrollit të hershëm, informimin, parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe kurimin e kësaj sëmundje.

Ashtu si të gjithë institucionet, organizatat, individët edhe stafi i Albsig, pjesë e Kastrati Group i bashkohet kësaj fushate edukuese për jetën.

Këtë vit, ndryshe nga vitet e tjera, target grupi i femrave që do të suportohen nga Albsig janë punonjëset e stafit.

“Kontroll Falas” për të gjitha punonjëset e Albsig. sh.a., Albsig Jetë dhe Albsig Invest. Kjo është nisma që ka ndërmarrë Albsig në këtë fushatë sensibilizimi në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe parandalimin e kësaj sëmundje, e cila do të jetë dhe një nga misionet e pandalshme të kompanisë.

Ky kontroll mjekësor rekomandohet dhe jepet falas për arsye depistuese për një sërë sëmundjesh që mund të prekin çdo lloj moshe në mënyrë ndoshta edhe të fshehtë nga ana klinike.

Mjekët e klinikës kanë të evidentuar të gjithë grupmoshën nga 25 deri në 60 vjeç që përfitojnë falas kontrollin dhe bëjnë njoftimin e tyre në mënyrë graduale për të shmangur edhe grumbullimet.



Albsig, Fushatë Sensibilizuese për Tetorin Rozë



“Roza është ngjyra ime, ngjyra jote...”

Albsig kthen "Pink October" në "Octoberfest" - në një "festë" për gratë dhe vajzat që për një muaj me radhë do të paraqiten te mjeku për vizitë dhe identifikojnë e zbulojnë problematikat e shëndetit dhe parandalojnë rrezikun e të shpëtojnë jetën! Janë në kohë, çdo grua, nënë, motër, vajzë, shoqe, kolege, për t'u kontrolluar, diagnostikuar dhe parandaluar!

Mos nguroni për asgjë, mos prisni "Pink October" po kontrollohu, në çdo moment dhe parandalo çdo të keqe që mund të sjellë neglizhenca. Këto janë thirrjet e herë pas hershme që dëgjojmë, por më së shumti në muajin Tetor, muaj ky i ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit. Të gjitha institucionet shtetërore e private, në kuadër të ndërgjegjësimit organizojnë fushata sensibilizuese për stafet përkatëse. Ndër to është edhe Albsig. sh.a., Albsig Jetë dhe Albsig Invest që përmes një fushate sensibilizuese, gjithësecila prej tyre dha mesazhin sensibilizues në kuadër të mbrojtjes dhe parandalimit të kancerit të gjirit.

“Roza është ngjyra ime, ngjyra jote.. kurrë mos u dorëzo”, këto ishin fjalët e hapjes së fushatës sensibilizuese ideuar dhe realizuar nga stafi i femrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Albsig. Të gjitha gratë dhe vajzat përmes një video mesazhi kanë bërë të mundur sensibilizimin përgjatë këtij muaji. Dhënia e video-mesazheve ka karakter informative, qëllimi i të cilit është që masa më e madhe e shoqërisë sonë, kryesisht gjinia femërore, të informohen për këtë lloj sëmundje, si të identifikohen simptomat e para të saj dhe masat parandaluese për të. Njëkohësisht konsumatorët e tregut dhe jo vetëm u njoftuan edhe për aktivitetet në vijim të fushatës. Pas shpërndarjes së video-mesazhit në rrjetet sociale do të vijojë fushata dhe në terren për kancerin e gjirit nga ana e punonjësve të Albsig.





ALBSIG FESTË PËR FËMIJËT E PUNONJËSVE ME RASTIN E FESTAVE TË FUNDVITIT

Fëmijët e punonjësve të Albsig u mbledhën për të kremtuar festat e fundvitit në ambientet e kompanisë. Një atmosferë fantastike u krijua nga spektakli i organizuar nga animatorët, ku nuk munguan edhe shumë dhurata për të vegjlit. Atmosfera festive, plot ngrohtësi, ku u mirëpritën vogëlushët dhe fëmijët e moshave të ndryshme, nis që nga kati i parë i godinës deri në zyrat e shoqërisë, për t'u stacionuar më pas në lokalin e përcaktuar për festë. Ndryshe nga vitet e tjera, fëmijët ishin kureshtarë të shikonin më nga afër postet e punës së prindërve. Me rastin e festave të fundvitit, Drejtori i Përgjithshëm i Albsig, z.Muharrem Bardhoci ka shtruar një koktejl për fëmijët e punonjësve duke i konsideruar ato si gjënë më të shtrenjtë në çdo familje. Duke mbajtur një fjalë përshëndetëse në këtë aktivitet, Z. Bardhoci i uroi përzemërsisht Vitin e Ri 2023 atyre dhe të gjithë fëmijëve të vendit. "Paqe dhe begati sjellte për ju viti i ri. Këtë urim ua kushtoj fëmijëve, këtyre diejve, që na ngrohin zemrën çdo ditë, që na bëjnë të ecim përpara, të ngrihemi kur rrëzohemi e të buzëqeshim për ta! Të ardhmen ua kushtojmë atyre!", theksoi në urimin e tij z. Bardhoci. Në emër të Albsig, pjesë e Kastrati Grup u shpërndanë dhurata për fëmijët e moshave të ndryshme që vizituan ambientet e Albsig e më pas u stacionuan në lokalin e përzgjedhur për ta. Kjo nismë është konceptuar si një kartolinë urimi, për të bërë sa më të lumtur vogëlushët të vegjlit dhe do të vazhdojë edhe gjatë viteve në vazhdim. Një urim i veçantë shkoi për çdo fëmijë që vjen këtë muaj në jetë! Eventi me fëmijët e punonjësve të Albsig ishte ideuar në mënyrë të tillë që fëmijët të shikojnë më nga afër punën e prindërve dhe të mësojnë sadopak në fushën e sigurimeve. Kishte dhe nga ato fëmijë që me vjersha dhe këngë në një minikoncert të vogël të realizuar nga animatorët e festës falenderuan Albsig për eventin e realizuar.











 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL